

Eranda HYSI u lind më 07 Janar 1984. Ka kryer studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitet 2002-2006. Ajo zotëron gjithashtu edhe titullin “Avokat”.

Nga Janari 2007 deri më Tetor 2020, ka ushtruar profesionin e juristit në pozicionin e sekretarit gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në vitet 2020-2021, ka ndjekur programin e formimit fillestar për Këshilltarë Ligjor pranë Shkollës së Magjistraturës.

Me vendimin nr. 486, datë 19.10.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor e emëroi Znj. Hysi, në pozicionin Këshilltar Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.